



Marrëveshje rreth bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe prindërve/kujdestarëve ligjorë të Brügg-ut

- 1. Drejtoria e shkollës, mësime dhënësit, prindërit dhe kujdestarët ligjorë janë të detyruar të angazhohen për bashkëpunim të ndërsjellë.**
- 2. Drejtoria e shkollës, mësime dhënësit, prindërit dhe kujdestarët ligjorë, si dhe nxënësit** trajtojnë njëri-tjetrin me respekt dhe mirësjellje. Dhuna dhe kërcënimet e dhunshme nuk tolerohen në asnjë mënyrë.
- 3. Mësime dhënësit ...**
 - ... inkurajojnë dhe mbështesin nxënësit në përputhje me nevojat e tyre individuale dhe krijojnë një mjedis motivues të të mësuarit.
 - ... janë përgjegjës për vendimet që ndikojnë në mësime dhënie.
 - ... informojnë prindërit rregullisht ose nëse është e nevojshme në një formë të përshtatshme, për nivelin e performancës, sjelljen e të nxënimit dhe punës dhe çdo sjellje jo normale.
 - ... informojnë herët në lidhje me datat dhe aktivitetet (letrat tremujore dhe semestrale).
 - ... vazhdojnë arsimimin e tyre në një formë të përshtatshme dhe në intervale të rregullta.
 - ... respektojnë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave.
- 4. Prindërit/kujdestarët ligjorë marrin pjesë aktive në aktivitetet e shkollës.**

Ata ...

 - ... informojnë mësime dhënësit rreth sjelljes në punë në shtëpi, për vështirësitë në mësime, ngjarjet e veçanta si dhe veçoritë në zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës së tyre.
 - ... marrin pjesë në mbledhjet dhe bisedat e prindërve. Nëse nuk janë në gjendje të marrin pjesë, duhet të njoftojnë mësuesin përkatës.
 - ... paraqiten në aktivitetet shkollore të fëmijës së tyre.
 - ... flasin me fëmijët e tyre rregullisht për gjendjen e tyre në shkollë (detyrat e shtëpisë, vështirësitë, sukseset në mësime, kontrollet e të mësuarit, ngjarjet e veçanta...)
 - ... mbështesin pajtueshmërinë me rregullat e shkollës.
 - ... lexojnë fletëpalosjet që fëmija i sjell në shtëpi.
- 5. Ushqyerja, ushtrimet, gjumi dhe koha e lirë.**

Mësime dhënësit ...

 - ... tematizojnë ushqyerje të shëndetshme në të gjitha ciklet, si pjesë e misionit të tyre.
 - ... kanë parasysh që të rinjtë dhe fëmijët të kenë qasje në aktivitetin fizik gjatë së përditshmërisë shkollore (shkollë aktive).

Shkolla ditore ...

 - ... kujdeset për një ushqyerje të shëndetshme dhe të ekuilibruar gjatë drekës dhe ndërmjet vakteve.
 - ... ofron një gamë të gjerë të aktiviteteve në kohën e lirë, të cilat inkurajojnë dhe mbështesin nxënësit në zhvillimin e tyre (sport, art, muzikë, teatër).

Prindërit/kujdestarët ligjorë ...

- ... i kushtojnë vëmendje të ushqyerit të shëndetshëm të fëmijëve të tyre.
- ... sigurohen që fëmijët e tyre të kenë ngrënë mëngjes para se të fillojë shkolla dhe/ose të marrin me vete diçka të lehtë për mëngjes.
- ... nëse është e mundur të hanë një vakt së bashku me fëmijën/fëmijët e tyre çdo ditë.
- ... kujdesen që fëmijët e tyre të ushtrojnë mjaftueshëm (rekomandim i Zyrës Federale për Sport 1 orë në ditë).
- ... kujdesen që fëmijët e tyre të kenë fjetur mjaftueshëm (rekomandime: fëmijët nën moshën dhjetë vjeç të paktën 10 deri 11 orë gjumë, fëmijët midis 10-13 vjeç 9 deri 10 orë gjumë, nga 14 vjeç 8 deri 9 orë gjumë).
- ... lënë fëmijët të shkojnë në shkollë të pavarur.
- ... dinë se çfarë bëjnë fëmijët e tyre në kohën e lirë..

6. Konsumimi i medias.

Mësimdhënësit ...

- ... Kujdesen që celularët të përdoren në kampe dhe ekskursione vetëm në kohë të caktuar dhe sipas marrëveshjes.
- ... tematizojnë në mënyrë të përsëritur gjatë mësimit rregullat për përdorimin e mjeteve dixhitale të shkollës dhe përdorimin e internetit në mënyrë kuptimplote dhe të sigurt.. .
- ... i kushtojnë vëmendje gjatë orës mësimore zgjedhjes së përshtatshme sipas moshës, të imazhit, filmit dhe videomaterialeve..

Shkolla ditore kujdeset që mediat të përdoren si duhet.

Prindërit/kujdestarët ligjorë ...

- ... janë të vetëdijshëm se TV-të, tastierat e lojërave dhe PC-të nuk u përkasin dhomave të fëmijëve..
- ... i kushtojnë vëmendje një përzgjedhjeje, sipas moshës, të filmave, lojërave, platformave të internetit ...
- ... vendosin rregulla me fëmijët e tyre në lidhje me konsumimin e medias (TV, internet, lojëra, etj. Vlerat e rekomanduara të udhëzuesit në ditë: maksimumi 60 minuta për fëmijët 6-9 vjeç, maksimumi 90 minuta për fëmijët 10-13 vjeç).

Një grup punues (anëtarë të komisionit shkollor, këshilli i prindërve dhe mësimdhënësit) ka hartuar marrëveshjet aktuale të lartpërmendura. Ato u miratuan nga komisioni dhe drejtoria e shkollës në takimin e 4.2.2010 dhe u rishikuan nga drejtoria e shkollës në dhjetor 2020.

Ne kemi lexuar marrëveshjet dhe jemi pajtuar. Me nënshkrim konfirmojmë që bashkëpunimi ynë bazohet në këto parime.

Emri i fëmijës:

Data: ... Nënshkrimi i prindërve:

Drejtoria e shkollës

Data:

Cikli 1: (M. Bilat)

Cikli 2:(U. Schor)

Cikli 3:(M. Rosin)